



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:233390

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05762806

C.nr. 973/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.D nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. R.M nga Vushtrria, rruga ... kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, jashtë seance me datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.D nga, komuna e Vushtrrisë dhe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën nga data 25.03.2021 e deri me datë 21.11.2022 (332 ditë pune), t'ia paguaj paditëses A.D shumën prej 664.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data dita e paraqitjes së padisë (31.10.2023), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditëses A.D, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja A.D nga, komuna e Vushtrrisë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. R.M në Vushtrri, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datë 31.10.2023, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që t'ia kompensoj shpenzimet e ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën nga data 25.03.2021 e deri me datë 21.11.2022 (332 ditë pune), në shumën prej 664.00 euro, me kamatë ligjore vjetore prej 8%, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata me aktvendimin C.nr.973/23 të datës 09.02.2024, ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 13.02.2024, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 14.02.2024.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar me arsyetimin se Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 22.01.2021 ndërsa me datë 21.11.2022, është shkëputur nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa paditësja e ka paraqitur padinë në gjykatë me datë 31.10.2023. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe me kontratën numër 49/29 të datës 07.05.2021 për paditësen A.D.

Kontestuese nuk ishte prania në punë e paditëses nga data 25.03.2021 e deri me datë 21.11.2022 (332 ditë pune, pasi që ky fakt është provuar nga Vërtetimit i lëshuar me datë 25.10.2023, nga Drejtoria e SH.M.U “SH...”, në Vushtrri.

Kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë, paditëses nuk ia ka bërë kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë.

Kontestuese nga e paditura ishte parashkrimi i kërkesës së paditëses.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënjen e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se “kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”, si dhe vërtetimit të lëshuar me datë 25.10.2023 nga Drejtoria e SH.M.U “SH...”, në Vushtrri, për paditësen A.D për periudhën nga data 25.03.2021 e deri më 21.11.2022 (332 ditë pune), erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses është e bazuar, andaj edhe ia njohu shumën prej 664.00 euro, duke përlogaritur një ditë pune me 2,00 euro (332 x 2 = 664).

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjykata e vlerësoi si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, ndërsa paditësja kërkesën e saj e ka parashtruar për periudhën nga data 25.03.2021 deri më 21.11.2022, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 31.10.2023.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditëses ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartës prej 8% në vit, duke llogaritur nga data dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë (31.10.2023), e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par. 2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, për kamatën, me nr. 265/2020 i datës 01.12.2020.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së, duke ia njohur paditëses shumën prej 125.00 euro,

shpenzime këto të cilat iu referohen shpenzimeve për pagesën e taksës për padi në shumë prej 21,00 euro, si dhe për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr.973/23, me datë 31.05.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.